



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI BASHKISE VAU DEJES

VENDIM

Nr. 20 date 06/04 2020

Per disa ndryshime ne VKB Nr. 84, date 25.11.2019 Per "MIRATIMIN E TAKSAVE  
DHE TARIFAVE VENDORE PËR VITIN 2020"  
NE BASHKINE VAU-DEJES

Keshilli i Bashkise Vau-dejes, i mbledhur me date 24.01.2020, pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga Sektori i te Ardhurave, "Per Miratimin e Taksave dhe Tarifave vendore, per vitin 2020", mbeshtetur ne nenin 18, nenin 35, pika 1, germa a,b,c,dh,e dhe pikat 2,3,4,5, germa a,b,c,ç, neni 36, pika 1 dhe 2, neni 54, germa "f", neni 55, pika 3 te ligjit 139/2015, date 27.12.2015 "Per vetqeverisjen vendore", Ligjin 9632, date 30.10.2006 "Per sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr. 48/2019 "Per mbrojtjen Civile", VKM nr. 243, date 24.3.2020 "Per shpalljen e Gjendjes se fatkeqsise natyrore", Aktin Normativ nr. 3, neni 5, date 15.03.2020i qeverise shqiptare botuar ne fletoren zyrtare te RSH nr. 37, date 15.3.2020, neni dhe me kerkese te Kryetarit te Bashkise,

Pas diskutimit dhe miratimit me shumice votash:

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e ndryshimeve te VKB nr. 84, date 25.11.2019 "Per miratimin e taksave dhe tarifave vendore te Bashkise Vau-Dejes per vitin 2020" te ndryshuar.
2. Ketij Vendimi i bashkengjitet materiali me ndryshimet perkatese.
3. Ngarkohet per zbatimin e ketij vendimi Sektori Ardhurave.
4. Ky vendim u shpall sot me date 06/04/2020.
5. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 te ligjit nr. 139/2015.

SEKRETARI I KESHILLIT

Ardian Celepija

KRYETARI I KESHILLIT

Mark BISHA

## PROPOZIM

Per shtyrje te afatit te pageses se detyrimeve vendore, si dhe faljen e gjobave e kamat vonesave per nje periudhe 3-mujore, duke bere ndryshimet perkatese ne Paketën fiskale 2020

1. Tek Kapitulli i I/1.2.3.5 Taksat Vendore:
  - Tatim thjeshtuar mbi fitimin e biznesit vogel
  - Taksa mbi pasurine,(ndertese)
  - Taksa mbi truallin
  - Taksa e tabelës
  - Taksa fjetjes ne hotel

“Menyra e pageses”, per subjektet biznese

Ishte  
kesti I pare paguhet deri me 20.04.2020

behet

Shtyrja e ketij afati deri me 30.06.2020

2. Tek Kapitulli II “Tarifat Vendore”, Pastrim,Ndricim,Gjelberim dhe te Sherbimit administrative, menyra dhe afati I pagese per subjektet biznese

Ishte  
Kesti I pare paguhet deri me 20.04.2020

Behet

Shtyrja e ketij afati deri me 30.06.2020

3. Tek Kapitulli III Gjobat

Te falen gjobat dhe kamat vonesat per moslikujdim ne afat deri me 20.04.2020 te kестit te pare te detyrimeve tatimore vendore per subjektet biznese.

4. Per taksapaguesit familjar:

- Te pezullohen per 3 muaj (Prill, Maj,Qershор 2020) pagesat e detyrimeve vendore, duke ju kryer sherbimin perkates qe kerkojne.
- Te pezullohen njoftimet e ketyre taksapaguesve qe behen nepermjet postes, per keto 3 muaj, nga ana e Sektorit te te Ardhurave, por te behet parapregatitja e tyre, per tu derguar ne muajt ne vijim.

SEKRETARI I KESHILLIT

Ardian Çelepija



KRYETARI I KESHILLIT

Mark BISHA